

PROBLEMET TEKNIKE DHE LIDHUR ME FUSHËN E ARKIVIMIT TRADICIONAL DHE ELEKTRONIK

Radenci/Siloveni, 1-13 maj 2022

THIRRJE PËR DORËZIMIN E TEMAVE

Konferenca ndërkombëtare Problemet Teknike dhe të lidhura me Fushën e Arkivimit Tradicional dhe Elektronik mirëpret profesionistë nga fushat e shkencës arkivore, menaxhimit të dokumenteve dhe ata aktivë që punojnë në këto fusha që dëshirojnë të jenë të azhurnuar. Konferenca sjell risi në fushën e bazave teorike dhe praktike të shkencës arkivore dhe menaxhimit të dokumenteve, procedurat profesionale, kërkimet, standardet, udhëzimet, praktikatat më të mira, projektet dhe programet.

Organizatori, Arkivi Rajonal Maribor, fton me mirësi arkivistë, profesionistë në fushën e menaxhimit të dokumenteve dhe disiplina tjera përkatëse për të marrë pjesë me prezantime të punimeve që diskutojnë temat e mëposhtme:

Tema kryesore e konferencës 2022 do të jetë

Arkivat e përshtatshme për përdoruesit

Tema mbulon të gjitha procedurat profesionale arkivore: nga menaxhimi i të dhënave tek krijuesit dhe transferimi i tyre në arkivat kompetente, përpunimi i lëndës arkivore në arkiva dhe shpërndarja dhe përdorimi i lëndës arkivore nga përdoruesit. Në ditët e sotme, duhet të njihemi me të gjitha këto procedura si në mënyrën tradicionale në "letër" ashtu dhe në atë elektronike.

Qasja në lëndën arkivore

- bazat e të dhënave arkivore,
- mjetet ndihmëse për kërkim të lëndës arkivore,
- qasja në arkiva për personat me aftësi të kufizuara,
- mbrojtjen e të dhënave personale.

Të dhënat arkivore si kujtim për të ardhmen dhe garanci ligjore:

- të dhënat arkivore si trashëgimi kulturore,
- të dhënat arkivore si burime për historinë dhe shkencat e tjera,
- arkivat si garanci për mbrojtjen e të drejtave ligjore,
- metodat e përshkrimit dhe publikimit të lëndës arkivore dhe burimeve,
- problemet e ruajtjes së përhershme të lëndës arkivore në letër dhe në mënyrë elektronike.

Ndikimi i digjitalizimit dhe globalizimit në punën e arkivave:

- arkivat elektronike,
- përpunim dhe qasja në të dhënat arkivore elektronike,
- popullarizimi i arkivave (rrjetet sociale...),
- roli edukativ i arkivave.

Të gjitha temat e sipërpërmendura mund të lidhen me nën-temat e mëposhtme:

RUAJTJA AFATGJATE DHE E-ARKIVIMI

- E- Arkivimi
- E- Qeverisja, E- Edukimi, E- Shëndetësia

DIGITALIZIMI DHE TRANSFORMIMI DIGJITAL

- Përgatitja e lëndës arkivore (përshkrimi, standardet)
- Procedurat e digjitalizimit
- Qasja në lëndën arkivore dhe përdorimi i saj
- Prezantimi i projekteve të digjitalizimit

SIGURIA E INFORMACIONIT

- Siguria e sistemit të informacionit
- Siguria, privatësia dhe besimi në sistemet mobile
- Siguria e komunikimit, aplikimit dhe shërbimeve
- Siguria kibernetike
- Mbrojtja e të dhënave personale

MENAXHIMI I DOKUMENTEVE TEK KRIJUESI

- Përvetësimi i materialit arkivor dhe bashkëpunimi me krijuesit
- Përzgjedhja dhe asgjësimi i dokumenteve
- Vlerësimi i krijuesve
- Menaxhimi i dokumenteve dhe lëndës arkivore duke përdorur burimet e jashtme (procesi, eksperiencat)
- Menaxhimi i dokumenteve dhe arkivave (përvojat e krijuesve)
- Plotësimi i planeve
- Ruajtja e arkivave tek krijuesit

MENAXHIMI I DOKUMENTEVE TEK KRIJUESIT

- Procedura e blerjes së dokumenteve arkivore dhe bashkëpunimi me institucionet arkivore
- Problemet e përzgjedhjes dhe asgjësimit të dokumenteve aktuale
- Vlerësimi i krijuesve
- Plotësimi i planeve
- Rregullimi i dokumenteve dhe lëndës arkivore – kontraktimi i jashtëm
- Menaxhimi i dokumenteve dhe arkivave tek krijuesit
- Rregullat e brendshme lidhur me menaxhimin e dokumentacionit
- Ruajtja e lëndës arkivore

RUAJTJA E LËNDËS ARKIVORE

- Depot arkivore
- Dëmtimi i lëndës arkivore për shkak të kushteve të papërshtatshme të ruajtjes
- Konservimi dhe restaurimi i lëndës arkivore

Kur aplikoni, ju lutemi shënoni:

- emrin tuaj të plotë, titullin, emrin e institucionit në të cilin punoni, informacionin e kontaktit,
- titullin e temës së propozuar
- një abstrakt të shkurtër dhe
- 5 fjalë kyçe.

Një libër abstraktesh në slovenisht dhe anglisht do të botohet për konferencën; artikujt e plotë do të botohen në revistën **Moderna arhivistika** (Shkenca Arkivore Moderne).

Bordi editorial do t'ju informojë për vendimin e tij pasi të jenë pranuar të gjitha aplikacionet. Nëse jeni të përzgjedhur, atëherë do të merrni edhe udhëzime të mëtejshme mbi formën e artikullit. Të gjitha prezantimet në konferencë do të jenë në gjuhën slovene ose angleze.

**Ju lutemi që të paraqisni aplikimin tuaj jo më vonë se 15 shkurt 2022,
në adresën: mojca.kosi@pokarh-mb.si.**

Artikujt e plotë do të botohen në revistën **Moderna arhivistika** (Shkenca Arkivore Moderne). Gazeta filloi të publikohet më 2018 dhe vazhdon traditën e botimit të artikujve shkencorë dhe profesionalë të recensionuar nga fusha e shkencës arkivore, dokumentologjisë, menaxhimit të dokumenteve dhe shkencave të tjera, të lidhura me problemet e materialit dhe dokumenteve arkivore në arkiva, muze, biblioteka dhe galeri. Prezantohen risitë nga fusha e bazave teorike të shkencës arkivore dhe dokumentologjisë, proceset profesionale, hulumtimet, standardet, udhëzimet, praktikat më të mira, projektet dhe programet.

Të gjithë artikujt rishikohen nga kolegët dhe, sipas rishikimit, botohen ose si artikuj shkencorë origjinal, artikuj të rishqyrtuar, artikuj të shkurtër shkencorë ose artikuj profesionalë. **Artikujt botohen në gjuhën sllovene ose angleze.**

Revista Moderna arhivistika është pranuar në **bazën e të dhënave Scopus** në vitin 2021

Për shkak të procedurës së rishikimit nga kolegët, artikujt e plotë duhet të paraqiten në bordin editorial deri më **1 korrik 2022.**

Do të merrni udhëzime për përgatitjen e artikullit kur të pranohet punimi.

Ju mirëpresim